



ZYRA E KUVENDIT TË KOMUNËS
Sektori Ligjor dhe për punë të Kuvendit
01-Nr- _____
Me datën 05.12.2024

PLANII PUNES SË KUVENDIT TE KOMUNËS SË SUHAREKËS PËR VITIN 2025

Kuvendi i Komunës është organi me i larte në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetaret, dhe funksionon ne baze te Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve Ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Kuvendi i Komunës siguron kushte te punës për mbajtje te seancave te Kuvendit te Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetare gjate seancave. Siguron transparence te plote ndaj qytetareve për te gjitha vendimet dhe aktet tjera, si dhe për çdo gjë që është ne interes te qytetareve. Po ashtu, i'u krijon mundësi qytetareve qe përmes formave te ndryshme te jene pjesëmarrës ne proceset vendimmarrëse.

Plani i Punës se Kuvendit te Komunës se Suharekës është dokument i mbështetur ne Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës se Kuvendit dhe aktet tjera Ligjore dhe nënligjore. Plani është i hartuar ne baze te një kornize logjike i cili planifikon etapat e realizimit te punëve dhe detyrave te Kuvendit te bazuara ne detyrat dhe përgjegjësitë qe dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti dhe aktet tjera primare dhe sekondare.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2025, ku Kuvendi i Komunës se Suharekës, planifikon t'i mbaj 12, (dymbëdhjetë) seanca te rregullta, 6 (gjashtë) prej te cilave ne (6) gjashtëmujorin e pare te vitit 2025, ne te cilat do te trajtohen te gjitha çështjet qe janë ne interes te Komunës dhe te qytetareve te Suharekës, e te cilat janë te proceduara sipas akteve Ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Plani vjetor i punës se Kuvendit te Komunës, do te ndihmoje dhe lehtësoje punimet e mbledhjeve te Kuvendit, duke iu ofruar anëtareve te Kuvendit këtë plan, ata do te kenë nje pasqyre për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2025 e qe kane te bëjnë me interesat e qytetareve.

Përveç këtyre temave të cekura më poshtë, Kuvendi i Komunës së Suharekës, do të shqyrtoj dhe miraton edhe tema apo çështje tjera të cilat janë me rëndësi dhe në interes për qytetarët dhe Komunën e Suharekës.

Planifikimi i planit të punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë për vitin 2025.

Janar	1. Miratimi i vendimit për ndryshim plotësimin e vendimit 01-Nr-016-16358 i datës 28/01/2022 i komisionit për bursa të nxënësve dhe studenteve; 2. Informatë për aktivitetet e KKS-së për periudhën korrik-dhjetor të vitit 2024; 3. Miratimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) për periudhën 2025-2030 për Komunën e Suharekës; 4. Miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës; 5. Miratimi i Rregullores për zbatimin e bonuseve të zonimit për Komunën e Suharekës;	Aktivitetet
Shkurt	1. Njoftimi i planit të prokurimit për vitin 2025; 2. Raport pune për zyrën e prokurimit për vitin 2024; 3. Inicimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës; 4. Miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës se paluajtshme të Komunës; 5. Miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;	
Mars	1. Raporti përfundimtar financiar për vitin 2024; 2. Bartja e mjeteve vetanake të vitit 2024 për shfrytëzim në vitin 2025; 3. Miratimi i raportit të punës dhe aktiviteteve të Komisionit Komunal të aksionarëve për NPL “Stacioni i Autobusëve” në Suharekë për vitin 2024; 4. Miratimi i vendimit për këmbimin e pronës publike me pronë private; 5. Inicimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;	
Prill	1. Informate e Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare për 3 (tre) mujorin e parë të vitit 2025; 2. Raportimi për dhunën në familje; 3. Themelimi komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës; 4. Miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;	
Maj	1. Vendimi për ndarjen e shpërblimeve për nder të “13 Qershorit” ditës së çlirimit të Suharekës me rrethin; 2. Miratimi i raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afat gjatë pronës së paluajtshme të Komunës; 3. Inicimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës; 4. Miratimi i vendimit për caktimin e vlerës së bonus banimit për vitin 2025	
Qershor	1. Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (2026-2028); 2. Rishikimi i buxhetit për vitin 2025; 3. Themelimi komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës; 4. Miratimi i Rregullores për buxhetimin me pjesëmarrje;	
Korrik	1. Konsultimi publikut dhe pjesëmarrja e publikut në vendim marrje; 2. Informate e Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare për 6 (gjashtë)	

	mujorin e pare të vitit 2025; 3. Informatë për aktivitetet e KKS-së për periudhën Janar-Qershor të vitit 2025; 4. Raportimi i Kryetarit të Komunës për mbikëqyrjen e kontratave të dhënës në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës	
Gusht	1. Dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit për vitin 2026; 2. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së; 3. Miratimi i vendimit për caktimin e shkallës tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme; 4. Raport nga Drejtoria e Arsimit për përfundimin e vitit shkollor dhe fillimin e procesit mësimor	
Shtator	1. Miratimi i Buxhetit dhe Plani i Investimeve për vitin 2026; 2. Miratimi i vendimit për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyçi”; 3. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Jashtëm për vitin 2024;	
Tetor	1. Informate e Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare për 9 (nëntë) mujorin e pare të vitit 2025; 2. Miratimi i vendimit për përcaktimin e vlerës së normës tatimore; 3. Miratimi i Rregullores për transparencë në Komunën e Suharekës;	
Nëntor	1. Diskutim për sensibilizimin e qytetarëve kundër dhunës në familje; 2. Shqyrtimi i raportit të performancës së Komunës për vitin 2024; 3. Miratimi i Rregullores për dhënin në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës;	
Dhjetor	1. Planifikim i punës së Kuvendit dhe orari i mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit të Komunës së Suharekës, për vitin 2026; 2. Miratimi i planit vjetor të punës të këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2026; 3. Raporti për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së 4. Raporti për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së	

Përveç këtyre temave në Kuvendin e Komunës së Suharekës, do të shqyrtohen edhe tema tjera të cilat janë me rëndësi dhe në interes për qytetarët dhe Komunën e Suharekës.